# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436815**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri studentët e rinj: Fakti që jeni këtu do të thotë se nuk dëgjoni nga ai vesh, jeni frymëzim! |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/politike/protestuesit-i-kerkojne-ne-shesh-rama-mesazh-studenteve-te-rinj-fakti-q-i400983` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 12:59:01 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 12:54:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3b7f85c22c226c035beebd96e8e85463cfaab56fa4a27b99d2f795568767f0e7` |
| TEKSTI | `2c2745533bf5a3145b6b6378258aa846b6b436a24a6d539ede1f9e894f48cf05` |
| PAMJA | `b151ac56043d91b04bc372985878d45d0d9d069c9f6189e13af27266e0c8fea2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `234d3c2d35b621abfb0c62e795ac56c9f180a1dd1a8cc37d731825fb800cfb7e` |
| E MËPARSHMJA | `1a5b9a792ffd26b3dfc8e70859b835a25a0396752579d5c6e4314adb0e8ca950` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/234d3c2d35b621abfb0c62e795ac56c9f180a1dd1a8cc37d731825fb800cfb7e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese

12 numrat e parë FALAS!

Version PDF

Abonohu te Revista



Created and monetized by mediadesk

**Çështjet kryesore**

Live Updates

### Arrestohet Ergys Agasi

E Enjte 10:25

Live Updates

### "Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

E Hënë 09:32

Live Updates

### SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

E Martë 14:24

Politikë 11 Shtator 2026, 14:54

# Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri studentët e rinj: Fakti që jeni këtu do të thotë se nuk dëgjoni nga ai vesh, jeni frymëzim!

Shkruar nga Newsbomb

Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri
**Kryeministri Edi Rama takim me studentët e rinj**

Në shoqërimin e ministres së Arsimit, pasditen e sotme kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me disa nga maturantët ekselentë të cilët pritet të bëjnë zgjedhjet e tyre për degët që duan të ndjekin studimet e larta dhe nxënës me performancë të lartë në mësime, të cilët i mirëpriti në Kryeministri.

Duke folur për ëndrrat që mund të bëhen realitet nëse punohet fort dhe i dedikohet një kohë e mirë punës dhe studimeve, Rama i motivoi studentët e rinj, të cilët dhe i falënderoi që nuk kanë dëgjuar fjalët që qarkullojnë lart e poshtë, referuar këtu protestës qytetare, por kanë zgjedhur ta takojnë.

Teksa ditët e fundit shpesh janë bërë thirrje që studentët të bashkohen në protestë ku kërkohet ndryshimi i klasës politike, Rama para të rinjve foli fjalë zemre, në mesin e të cilave theksoi se fakti që ata kanë zgjedhur ta takojnë nga afër nënkupton se nuk e përkrahin tubimin.

*"Ju jeni shembull i jashtëzakonshëm, jeni shembulli se si Shqipëria duhet të funksionojë. Forca juaj është heroike e fjalës, të jesh hero nuk do të thotë të japësh jetën. Do të thotë të kapërcesh të gjitha pengesat që të tjerë në disa kushte as nuk do të mendonin që t'i kapercejnë. Fakti që ju jeni këtu do të thotë se nuk dëgjoni nga ai vesh, dhe është mirë të mos dëgjoni. Sa më shumë të bëni sukses aq më të shumtë do të jenë zërat se vlerësimi i bërë nuk është i merituar.*

*Ajo që dua t'ju them sot është së pari se ju jeni frymëzim. në punë që unë bëj kam nevojë që të frymëzohem nga shembuj njerëzisht në kushtet që nuk janë në kushtet ideale për të bërë sukses por në fakt bëjnë sukses.Kur e bëni ju, unë patjetër që do e bëj. Jeni inspirim njëjtë siç janë ata që janë të suksesshëm në dritat e skenës. Ju nuk je i në dritat e skenës, sot po përfitoni nga ky moment, po pastaj do të vazhdoni larg këtyre dritave. Ju them me bindje, kini besim të palëkundur te vetja"* tha Rama para studentëve të rinj.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kreu i qeverisë shqiptare i motivoi më tej të rinjtë e pranishëm, të cilëve iu bëri me dije se sado vështirësi të të japë jeta, nuk duhet të dorëzohen për të arritur aty ku ata kanë ëndërruar.

*"Do të keni momente që do ju rrëshqasë një fitore nga duart, jeta do t'ju sprovojë duke ju nxjerrë përpara një hall të madh. Por varet e gjitha nga ju dhe forca juaj që përballë mjegullës të zezë të besoni se maja e ajsbergut që keni parë është e juaja dhe vetëm ju e arrini. Këtë ua them jo nga lartësia e detyrës por e eksperiencës"* përmbylli fjalën e tij kryeministri.

Më tej, në praninë e ministres Mirela Kumbaro, Rama u dha medaljet e çmimeve studentëve të pranishëm të cilët kishin shënuar sukses në Olimpiadat e zhvilluara në lëndë të ndryshme.

**Pamje nga takimi:**

Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri

Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri

Protestuesit i kërkojnë në shesh, Rama pret në Kryeministri

Galeria fotografike (
)

### Sondazh

Poll

### Lexo gjithashtu

Politikë

[5 vjet nga përjashtimi i Sali Berishës nga PD, kur Ambasada Amerikane i bënte jehonë vendimit të Lulzim Bashës dhe udhëtimi i parë i liderit demokrat në SHBA]

E Premte 15:04

Politikë

[Nga Kuvendi zyrtarisht te Shëndetësia, ministrja Spahiu tregon prioritetet: Transformoj sistemin]

E Premte 14:02

Politikë

["Më vjen ndot", ministrja Erjona Ismaili e sfidoi për të ardhur në Shqipëri, Arben Ahmetaj e injoron nga arratia: Kush është kjo? E njihni ju, se unë jo (REAGIMI)]

E Premte 13:10

Politikë

[Nga sot pjesë e stafit në Kryeministri, Besfort Lamallari reagon pas lirimit si ministër: Ka qenë nder për mua, tani do t'ia kthej Ramës besimin që pati]

E Premte 13:03

Politikë

[Rama e bëri sot ministër të Brendshëm, Gazment Bardhi zbulon lidhjen e Ervin Demos me kreun e SPAK: Braho të distancohet]

E Premte 12:35

Politikë

[Politologu i njohur kritikon reagimin e Ramës dhe Demos pas propozimit për ministër: Emërimi kalon nga Presidenti dhe Kuvendi]

E Premte 12:00

Politikë

[“Prania Besnike” e socialistëve vihet në praktikë duke filluar nga SOT, do të marrin pjesë edhe ministrat]

E Premte 11:57

Politikë

[Sali Berisha sfidon Altin Dumanin dhe SPAK-un nga Amerika, takon Prokurorin e Përgjithshëm të SHBA-së]

E Premte 11:32

Politikë

[Rama u shfaq në Pogradec me “Benz”-in mbi 100 mijë euro, ministrja: E paguajmë me lekët e buxhetit të PS-së! E nevojshme për sigurinë e kryeministrit]

E Premte 11:25

Politikë

[Karakaçi zbulon tri projektet 110 milionë euroshe për energjinë elektrike, përgjigjet dhe për zhvendosjen e mbikalimeve në autostradë]

E Premte 11:23 Newsbomb

Politikë

[Audiopërgjimi dhe akuzat e Ahmetajt, reagon ministrja e Ramës: Kam ndot, je i zhytur në llumin tënd! Po ke guxim hajde përballu me drejtësinë]

E Premte 11:07

Politikë

[U kallëzua nga ish-ortaku se fshehu dhe pastroi 1.5 milionë euro, deputeti demokrat Luan Baçi merret nën hetim nga SPAK]

E Premte 10:53

Politikë

[Ministria tregon zonat ku janë apartamentet 60 mijë euro për të rinjtë: Pastaj le ta shesin, të blejnë një më të madh]

[Ministri ja tregon zonat ku janë apartamentet 60 mijë euro për të rinjtë: Pastaj le ta shesin, të blejnë një më të madh]

E Premte 10:46

Politikë

[Ambasada e SHBA-së në Tiranë përkujton 25-vjetorin e 11 Shtatorit: Nderim për viktimat dhe heronjtë]

E Premte 09:59

Politikë

[U vendos në krye të Ministrisë së Brendshme, Ervin Demo falenderon Ramën për besimin: Do vazhdoj të çoj përpara punën e nisur nga Besforti]

E Premte 10:33

Politikë

[Edi Rama merr me vete në Kryeministri Besfort Lamallarin: Faleminderit për shërbimin si ministër i Brendshëm]

E Premte 10:25

**Revista**

Abonohu tani dhe lexoje

### Lajmet e fundit

Aktualitet

[Banorët e Marinzës dhe Belinës fitojnë "betejën", kinezët do i paguajnë për tokat e tyre, "Bankers"-i jep lekë deri në 2029]

E Premte 15:26 Newsbomb

Ekonomi

[Euro prek minimum të ri, thyen për herë të parë edhe pragun e 92 lekëve]

E Premte 15:17
Zbulo më shumë artikuj ›

Hapësire reklamuese

## bombvideo

Shiko video të tjera në Newsbomb Youtube

[Blutë e Vlorës prangosin dy "skifterët" që vodhën 3 makina, 40 vjeçari grabiti Benz-in deri...]

[Më i "lumtur se kurrë, Berisha merr pjesë në Konventën e Republikanëve të Trump]

[18 vjeçari "nuk zë mend", Policia i tregon vendin: Ishte në arrest shtëpie për vjedhje, doli dhe...]

["Të ecim me tjetër ritëm", Taulant Balla kërkon bashkëpunim me opozitën për Shqipërinë në BE]

[Intervista e Arben Ahmetajt, Bardhi thumbon keq socialistët: Ia jepni vetë informacionet]

[Aksident në autostradën Levan-Tepelenë, makinat përplasen "kokë më kokë"]

# op
# ed

OpEd

[Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor]

E Diel 16:23 Adri Nurellari

OpEd

[Një moment vendimtar për Shqipërinë]

E Martë 13:45

OpEd

[Një dritare mundësie për Tiranën: Pse "Jo"-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë]

E Diel 18:33

Newsbomb është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

Drejtor i Përgjithshëm: Retin Toka
NIPT: L42417011Q

Abonohu te Revista
Created and monetized by mediadesk

- Politikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Kulturë & Art
- Rajon

- Sport
- Bota
- Teknologji
- Showbiz
- SocialBomb

Merr lajme me email ME REGJISTRO

- Kontakt
- Të drejtat e përdorimit
- Cookies

Created and monetized by mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.